



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

**PSH.nr.976/20**

**PANELI SHQYRTUES**, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr.04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Blerim Dina – Kryetar, panelist individual, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “Albo Group” SH.P.K, & “Ekovizioni”-Prishtinë, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Hartimi i Strategjisë së AMKMK-së ” me nr. të prokurimit: 253-20-6620-2-3-6, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës, më datën: 01.12.2020, mori këtë:

## **V E N D I M**

**I. APROVOHET**, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Albo Group”SH.P.K, & “Ekovizioni”-Prishtinë, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Hartimi i Strategjisë së AMKMK-së ” me nr. të prokurimit: 253-20-6620-2-3-6, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës.

**II. ANULOHET**, njoftimi për anulim për aktivitetin e prokurimit me titull “Hartimi i Strategjisë së AMKMK-së” me nr. të prokurimit: 253-20-6620-2-3-6, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës, dhe lënda të kthehet në **rivlerësim**.

**III.** Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

**IV.** Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

**V.** Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: “Albo Group”SH.P.K, & “Ekovizioni”-Prishtinë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimin të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## ARSYETIM

Operatorët ekonomik ankues “Albo Group”SH.P.K, & “Ekovizioni”-Prishtinë, si palë të pa kënaqur kanë deponuar ankesë në OSHP, me 19.11.2020 me nr. 976/20, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Hartimi i Strategjisë së AMKMK-së” me nr. të prokurimit: 253-20-6620-2-3-6, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- “Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 59, 60, 62 dhe 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, dhe nenin 44.5 të RROUPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konfirmon nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 23.11.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 25.11.2020, lidhur me pretendimin ankimor të OE-ankues sqaron si në vijim:

Pas shqyrtimit në detaje të lëndës së tenderit lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe duke u bazuar në dokumentacionin në dispozicion, eksperti shqyrtues jep këtë mendim si në vijim: Sa i përket pretendimit të Autoritetit Kontraktues ku thuhet që OE ankues është i papërgjegjshëm sepse ka prezantuar vetëm një referencë të natyrës së ngjashme, ndërsa janë kërkuar dy si dhe nuk ka prezantuar certifikata lidhur me trajnimet (të prezantojë certifikata për trajnime dhe hartimin e legjislacionit dhe për trajnime në organizimin e moduleve të trajnimit), Eksperti Shqyrtues pas shqyrtimit të listës së kontratave dhe dëshmive dokumentare të dorëzuara nga OE ankues, gjen pretendimin ankimor si pjesërisht të pabazuar. Arsyetimi vijon si më tutje: Për faktin që kërkesa e shënuar nga AK në FDT dhe Njoftim për Kontratë ka qenë e specifikuar që OE të ofertojë kontrata të natyrës së ngjashme me fushëveprim si në vijim: hartimin dhe analizimin e legjislacionit, përvojën në hartimin e akteve strategjike strategjive, vendimeve dhe opinionëve ligjore, njohuri për legjislacionin për administratën publike, legjislacionin për zyrtarët publik si dhe legjislacionin për AMKMK-në, Eksperti vlerëson që kontratë e prezantuar si referencë të OE ankues, gjegjësisht vlerësimi i fushëveprimit të tyre duhet dekompozuar në termet e referencave për më në detaje për të parë nëse këto të



fundit përkojnë me çka është kërkuar në këtë aktivitet të prokurimit. Konform dispozitave ligjore në fuqi të shënuara edhe në RRUOPP, mbetet nën diskrecion të Autoritetit Kontraktues që ky i fundit mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të LPP-së. Për faktin që lista e kontratave përfshin gjithsej 29 kontrata (5 nga Albo Group dhe 24 nga partneri i tyre i konzorciumit Ekovizioni – shih faktin me numër 3) të cilat janë të shënuar si referencë e që kanë natyrë të ngjashme apo të njëjtë me aktivitetin e tanishëm të prokurimit, mbetet nën përgjegjësinë juridike të Autoritetit Kontraktues që të konstatojë nëse përmbajtja (shërbimet e kryera në këtë rast) e tyre përkon me fushëveprimin e këtij aktiviteti të prokurimit.

Sa i përket pretendimit të Autoritetit Kontraktues ku thuhet që OE ankues është i papërgjegjshëm sepse nuk ka prezantuar certifikata lidhur me trajnimet relevante ku konform kërkesës së shënuar në FDT dhe në Njoftim për Kontratë është dashur të ofrojë certifikata për trajnime dhe hartimin e legjislacionit sikurse edhe atyre të natyrës së zhvillimit të moduleve të trajnimit, Eksperti Shqyrtues pas shqyrtimit të dokumentacionit të tenderit dërguar nga OE ankues e gjen pretendimin si pjesërisht të bazuar. Përderisa përgatitja akademike e Menaxherit të Projektit përcaktuar nga OE ankues përkon me fushëveprimin e aktivitetit marrë parasysh natyrën juridike në thelb të këtij të fundit, certifikatat për trajnime dhe hartim të legjislacionit janë më gjithëpërfshirëse për nga ana teknike. Si të tilla, mbetet nën përgjegjësinë e AK-së që këto certifikata së bashku me referencat për projektet e mbikëqyrura të vlerësohen më në detaje për nga fushëveprimi i tyre, dhe të vlerësohen nëse bashkërendojnë me kërkesat e paraqitura në FDT dhe Njoftim për Kontratë konform nenit 72 të LPP-së. Duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, kronologjinë e rastit në fjalë dhe natyrën e pretendimeve, Eksperti shqyrtues e sheh ankesën e operatorit ekonomik ankues si pjesërisht të bazuar, duke sugjeruar kështu që për anulim të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit numër “253-20-6620-2-3-6”, respektivisht atij me titull “Hartimi i Strategjisë së AMKMK – së”, iniciuar nga AK – AGJENCIA PËR MENAXHIMIN E KOMPLEKSEVE MEMORIALE TË KOSOVËS (AMKMK), të anulohet dhe lënda të kthehet në rivlerësim. Një sugjerim i tillë vjen si rezultat i konstatimeve të pretendimeve.

#### Mendimi i ekspertit shqyrtues

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues duhet të jetë: pjesërisht e bazuar dhe lënda të kthehet **në rivlerësim**.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 25.11.2020 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 27.11.2020, me anë të parashtrësës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk-pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

DATE/A:	27.11.2020
PËR/ZA/TO:	Panelin Shqyrtues, Ekspertit Shqyrtues
CC:	z. Bislim Zogaj, Drejtor AMKMK
PËRMES/PREKO/THROUGH	
NGA/OD/FROM:	Z. Besim Mulaj-Udhëheqës Divizionit të Prokurimit - AMKMK
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Përgjigje ne ekspertizën me nr. 976-20, te datës 25.11.20

Te nderuar, Pas pranimit te ekspertizës me nr. 976-20 lidhur me ankesën e OE: “Albo Group”SH.P.K & “Ekovizioni” për AP me titull: “Hartimi i Strategjisë së AMKMK - së” me nr. te prokurimit: AMKMK-20-029-236 (elektronike 253-20-6620-236). AK-AMKMK ju informon se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues sepse edhe vet eksperti ne raportin e tij nuk ka konstatuar se ne kemi shkelur ndonjë nen te LPP-së apo te RRUOPP-së dhe nuk e kuptoj nëse pjesërisht ka te drejte qe do te thotë se ne disa pika te ankesës ka te drejte e ne disa jo atëherë si duhet te kthehet lënda ne rivlerësim apo si te vlerësojmë ne si AK. Po ju sqarojmë edhe njëherë kërkesat e AK ne FDT: Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar një sukses kontrata te natyrës së ngjashme ( në hartimin dhe analizimin e legjislacionit, të ketë përvojë në hartimin e akteve strategjike strategjive, vendimeve dhe opinioneve ligjore, të kenë njohuri për Legjislacionin për administratën publike, legjislacionin për zyrtarët publik si dhe legjislacionin për AMKMK-në, të realizuara në tri vitet e shkuara duke filluar nga Njoftimi për Kontratë , se paku dy (2) referenca . Evidenca 1. Listën e kontratave të natyrës se ngjashme të realizuara në tri vitet e shkuara duke filluar nga Njoftimi për Kontratë, duhet të dorëzohet ne origjinal e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik si dhe te bashkëngjiten si dëshmi edhe referenca ose pranimi teknik. Duke u bazuar ne kërkesat dhe dëshmitë e kërkuara nga AK te cilat janë te specifikuar se cilat referenca mund te merren për baze gjate vlerësimit dhe sipas vet ankesës se OE nuk i posedon 2 referenca sipas kërkesave, AK ne ketë rast ka vlerësuar se vetëm referenca e pare e prezantuar ne ankese i plotëson kërkesat e AK. “Hartimi i strategjisë zhvillimore lokale të turizmit 2020-2024 në komunën e Skenderajt” – Kjo reference është ne përputhje me kërkesat e dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontrate.

Organizimi i punëtorive për rishikimin të strategjisë së “Rrjetit të Organizatave për Zhvillim Rural të Kosovës” - nuk përkon me kërkesat e AK- analizoni referencën e prezantuar ku ne paragrafin e pare thotë, citat: Kompania ALBO Group ka ofruar shërbim dhe logjistikë, ketë nuk e ka analizuar fare eksperti.



“Mbështetje teknike për hartimin planit të menaxhimit të parkut Gërmia” - kjo kontrate nuk ka të beje me kërkesat e AI< fare, nuk është analizuar fare nga eksperti nëse e shohim numrin e AP 616- 19-1864-322 është shërbime këshilluese dhe ne reference ka shërbime krejtësisht tjera me ato të kërkuara ne dosje të tenderit dhe ne njoftimin për kontrate. “Fuqizimi i organizatave të shoqërisë civile dhe qytetareve në mbrojtje të mjedisit në nivel lokal” -nuk është siç është kërkuar ne dosje të tenderit dhe ne njoftimin për kontrate. Lidhur me piken e dyte të ankesës, kërkesa e AI< është si me poshtë: Kërkesa 2. OE duhet të prezantoj stafin Professional dhe menaxherial, Një menaxher të projektit, të cilët duhet të ketë diplome universitare , me përvojë 7 vjeçare të kenë përfunduar trajnime për hartimin e Legjislacionit, të kenë të përfunduar trajnimin për organizimin dhe zhvillimin e moduleve të trajnimit etj. Evidenca 2 Dëshmi për stafin profesional dhe menaxherial. Vendim me shkrim mbi caktimin e një menaxheri të projektit i vulosur dhe nënshkruar nga OE ne origjinal Dëshmitë për menaxher të projektit Kopja e diplomës, CV-it, të prezantoj certifikata për trajnime dhe hartimin e legjislacionit dhe për trajnime ne organizimin dhe zhvillimin e moduleve të trajnimit, kopja e kontratës së punës apo marrëveshje për këtë projekt Sa i përket pikës së dyte vërehet shumë qarte se as OE ankues dhe as eksperti shqyrtues nuk ka ofruar asnjë dëshmi se si vlerësimi i AK nuk është bërë drejtë, eksperti është thirrur në përgatitjen akademike të ekspertit të angazhuar që nuk ka të beje me kërkesën e AI< sepse nuk ka prezantuar asnjë certifikatë të kërkuara sipas dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontrate. Eksperti nuk ka konstatuar asnjë shkelje të AK dhe në anën tjetër kërkon të Rivlerësohet AP, nëse kemi shqyrtuar në mënyrë detale ofertën e OE ankues dhe është vlerësuar me të drejtë si OE që nuk i plotëson kërkesat e AK, po ashtu edhe OE tjetër nuk ka plotësuar kërkesat e AI< andaj AI< duke u bazuar në nenin 44,paragrafi 44.5,pika (ii) të RRUOPP-se ka anuluar AP. Andaj AK nuk pajtohet me ekspertizën me nr. 976-20 dhe kërkon nga Paneli Shqyrtues të refuzoj ankesën e OE dhe të lejoj AK të vazhdoj me këtë AP. Me respekt.

Operatori Ekonomik: “Albo Group” SH.P.K, & “Ekovizioni”-Prishtinë, me datë: 27.11.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në se pajtohet pjesërisht me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 01.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Albo Group" SH.P.K, & "Ekovizioni"-Prishtinë, se AK e ka eliminuar me arsyetimin se OE ankues është i papërgjegjshëm sepse ka prezantuar vetëm një referencë të natyrës së ngjashme, ndërsa janë kërkuar dy, si dhe nuk ka prezantuar certifikata lidhur me trajnimet (të prezantojë certifikata për trajnime dhe hartimin e legjislacionit dhe për trajnime në organizimin e moduleve të trajnimit), Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues kërkesa e shënuar nga AK në FDT dhe Njoftim për Kontratë ka qenë e specifikuar që OE të ofertojë kontrata të natyrës së ngjashme me fushëveprim si në vijim: hartimin dhe analizimin e legjislacionit, përvojën në hartimin e akteve strategjike strategjive, vendimeve dhe opinioneve ligjore, njohuri për legjislacionin për administratën publike, legjislacionin për zyrtarët publik si dhe legjislacionin për AMKMK-në. Lidhur me këtë kërkesë të AK-së, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson që kontratë e prezantuara si referencë të OE ankues, gjegjësisht vlerësimi i fushëveprimit të tyre duhet dekompozuar në termet e referencave për më në detaje për të parë nëse këto të fundit përkojnë me çka është kërkuar në këtë aktivitet të prokurimit. Konform dispozitave ligjore në fuqi të shënuara edhe në RRUOPP, mbetet nën diskrecion të Autoritetit Kontraktues që ky i fundit mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të LPP-së. Kjo për faktin që lista e kontratave përfshin gjithsej 29 kontrata (5 nga Albo Group dhe 24 nga partneri i tyre i konzorciumit Ekovizioni) të cilat janë të shënuar si referencë e që kanë natyrë të ngjashme apo të njëjtë me aktivitetin e tanishëm të prokurimit. Andaj, mbetet nën përgjegjësinë juridike të Autoritetit Kontraktues që të konstatojë nëse përmbajtja (shërbimet e kryera në këtë rast) e tyre përkon me fushëveprimin e këtij aktiviteti të prokurimit.

Sa i përket pretendimit të autoritetit kontraktues, ku thuhet që OE ankues është i papërgjegjshëm sepse nuk ka prezantuar certifikata lidhur me trajnimet relevante konform kërkesës së shënuar në FDT dhe në Njoftim për Kontratë dhe është dashur të ofrojë certifikata për trajnime dhe hartimin e legjislacionit sikurse edhe atyre të natyrës së zhvillimit të moduleve të trajnimit. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues pas shqyrtimit të dokumentacionit të tenderit të dërguar nga OE ankues, e gjen pretendimin si pjesërisht të bazuar. Përderisa përgatitja akademike e Menaxherit të Projektit përcaktuar nga OE ankues përkon me fushëveprimin e aktivitetit marrë parasysh natyrën juridike në thelb të këtij të fundit, certifikatat për trajnime dhe hartim të legjislacionit janë më gjithëpërfshirëse për nga ana teknike. Si të tilla, mbetet nën përgjegjësinë e AK-së që këto certifikata së bashku me referencat për projektet e mbikëqyrura të vlerësohen më në detaje për nga fushëveprimi i tyre, dhe të vlerësohen nëse bashkërendojnë me kërkesat e paraqitura në FDT dhe Njoftim për Kontratë konform nenit 72 të LPP-së.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, si dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues e ka anuluar aktivitetin e prokurimit në kundërshtim



me nenin 62 të LPP-së. Andaj, obligohet AK që të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, duke kërkuar sqarime lidhur me kontratat dhe certifikatat e trajnime sipas kërkesës së dosjes së tenderit, si dhe të bëjë vlerësimin e tenderëve në harmoni me dispozitat e LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues  
Blerim DINA



**Vendimi t'i dorëzohet:**

- 1x1 AK "Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës";
- 1x1 OE "Albo Group"SH.P.K, & "Ekovizioni"-Prishtinë;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.